Gjuha dhe integrimi

Shoqëria
Ofertat për integrim
Gjuha
Mësimi i gjermanishtes

Shoqëria

Nga të huajt pritet që të integrohen në shoqëri. Kjo do të thotë rrespektimi i ligjeve, pavarësia ekonomike dhe mësimi i gjuhës gjermane.

Parimet më të rëndësishme

Të gjithë banorët e Zvicrës janë të detyruar ta respektojnë Kushtetutën Federale (p.sh. barazia gjinore burrë/grua) dhe t'u përmbahen ligjeve në fuqi. Pëveç kësaj pritet që ekonomikisht të përkujdesen për vetëveten, nëse është e mundshme. Prej të huajve kërkohet edhe, që sa më shpejt që të jetë e mundur, ta mësojnë gjuhën e cila flitet në vendbanim. Mirëpo integrimi mund të ketë sukses vetëm nëse të dyja palët japin kontribut për këtë. Për këtë arsye prej popullatës vendore pritet hapja kundrejt të të huajve.

Përgjegjësia individuale

Federata, Kantonet dhe Komunat përkujdesen, që të huajt të kenë pjesëmarrje të drejtë në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Të huajt nga ana e tyre janë të detyruar me përgjegjësi individuale të përpiqen që të integrohen. Prej tyre pritet që ti shfrytëzojnë ofertat e vëna në dispozicion.

Pjesëmarrja në jetën shoqërore

Mundësi të mirë për tu integruar në shoqërinë zvicerane dhe për të njohur njerëz ofrojnë shoqatat. Mirëpo edhe festat dhe manifestimet në Komunën e vendbanimit janë të përshtatshme për të lidhë kontakte. Fillimi mundet me qenë paksa i vështirë, jo të gjithë banorët e Zvicrës janë njësoj të hapur kundrejt kulturave të huaja. Nganjëherë nevojitet paksa këmbëngulje.

Informata / mbështetje

Në Kantonin Glarus për banorët e ri (sapovendosur) ka në dispozicion zyra të ndryshme të kontaktit. Vendi i parë më i mirë për tu paraqitur është Komuna e vendbanimit. Mirëpo ka edhe zyra të tjera specifike për migrantët. Këto informojnë për jetën në Zvicër dhe ju përgjigjen pyetjeve konkrete për tema të ndryshme. Kush ende nuk flet gjermanisht mundet me e sjellë ndonjë përkthyes apo të kërkoj përkthyes. Disa zyra kontakti informojnë edhe në gjuhë të tjera. Për disa grupime gjuhësore ka zyra takimi në gjuhën e tyre.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-glarus.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/integrimi

Ofertat për integrim

Integrimi ndodh para së gjithash në shkollë, në arsim profesional dhe në punë. Për personat të cilët (ende) nuk kanë qasje në këto fusha ekzistojnë oferta të ndryshme për integrim.

Ofertat specifike

Ka oferta të shumta të posaçme për të huajt të cilat ndihmojnë për t'u ambientuar në shoqërin zvicerane dhe për të lidhë kontakte. Përveç tjerash ka biseda pranë tavolinës së rrumbullakët, oferta për kalimin e kohës së lirë, referate ose kurse. Zyra e specializuar për shoqërinë ju informon për ofertat. Shumë Komuna e organizojnë një manifestim për t'i përshëndetur banorët e rinj- kjo është një mundësi e mirë, për ta krijuar përshtypjen e parë.

Shoqatat

Shumë banorë të Kantonit Glarus janë anëtarë të ndonjë shoqate (Verein). Ka shumë shoqata për çështjet më të ndryshme. Edhe në Komunat e vogla ekzistojnë shoqata për sport, kulturë dhe shoqata të tjera. Ato ofrojnë mundësi ideale për të rënë në kontakt me njerëzit e tjerë. Shumica e shoqatave janë të hapura për të gjithë personat. Informatat në lidhje me shoqatat gjenden në webfaqet e Komunave.

Organizatat e emigrantëve

Mvarësisht prej ghuhës, vendit të origjinës ose religjionit ka shoqata të ndryshme, në të cilat migrantët organizohen vetë. Shpesh ofrojnë këto shoqata oferta për integrim dhe këshillim për t'i mbështet antarët e tyre kur vijnë në Zvicër dhe në Kantonin Glarus.

Oferta për rininë

Në Kantonin Glarus ka shumë oferta specifike për rini për ta kaluar kohën e lirë dhe për të njohur bashkëmoshatarë. Në shumicën e Komunave ka pikëtakime dhe oferta të ndryshme për ta kaluar kohën e lirë. Të rinjët janë nën përkujdesje, munden me i sjellë idetë e tyre dhe me zbatue projekte (Jugendarbeit). Ofertat janë kryesisht falas. Shoqatat për rini ofrojnë mundësi për të ndërmarrë aktivitete sëbashku me bashkëmoshatarë dhe për t'u marrë me sport në natyrë. Bartës të ofertave janë shoqatat, Komunat apo Kishat zyrtare. Ofertat janë të hapura për të gjithë të rinjët. Komuna e vendbanimit jep informata të tjera.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-glarus.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/ofertat-per-integrim

Gjuha

Prej banorëve të cilët nuk e flasin gjuhën gjermane pritet nga Kantoni Glarus që të mësojnë gjermanisht. Njohuritë e gjuhës janë parakushti kryesor për të pasur sukses integrimi në shoqëri dhe tregun e punës.

Gjuha zyrtare gjermane / Gjermanishtja zvicerane

Zvicra ka katër gjuhë zyrtare: gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe retoromanisht. Në Kantonin Glarus gjuhë zyrtare është gjermanishtja. Ka dallim ndërmjet gjuhës zyrtare gjermane (Hochdeutsch) dhe gjermanishtes zvicerane (Schweizerdeutsch). Në shkollë dhe pjesërisht edhe në radio dhe televizion flitet gjuha zyrtare gjermane (Hochdeutsch). Poashtu edhe shkrimi bëhet në gjuhën letrare gjermane. Në përditshmëri flitet megjithatë gjermanishtja zvicerane. Në këtë rast kemi të bëjmë me një dialekt të gjermanishtes i cili edhe për personat me njohuri të mira të gjuhës gjermane nuk është gjithnjë lehtë për ta kuptuar. Nga të huajt nuk pritet që të flasin gjuhën gjermane zvicerane, mirëpo pritet prej tyre që pas njëfarë kohe ta kuptojnë atë. Lejohet krejtësisht që nga zviceranet dhe zvicranët të kërkohet që ta flasin gjuhën letrare gjermane.

Gjermanishtja dhe fëmijët

Sygjerohet që fëmijët të cilët flasin ghuhë tjera, sa më herët që të jetë e mundur, të bien në kontakt me fëmijët të cilët e flasin gjuhën gjermane. Për këtë janë ideale grupet për lojë (Spielgruppen) apo ofertat speciale për prindër dhe fëmijë. Prindërit munden ti mbështesin fëmijët e tyre duke folur shumë me ta, duke i dëgjuar dhe duke ju treguar përralla. Ata duhet ta bëjnë këtë në gjuhën të cilën e zotërojnë më së miri.

Përkthimet

Nuk mund të pritet, që dikush menjëherë pas ardhjes këtu, të kuptoj dhe flas mirë gjermanisht. Mirëpo ka situata në të cilat duhet të kuptoheni. Shumë të posaardhur i lusin të afërmit apo të njohurit e tyre për të përkthyer për ta. Gjatë bisedave të komplikuara, personale dhe të besueshme ndoshta do të ishte më mirë nëse e merrni një përkthyese apo një përkthyes profesional. Përkthyeset dhe përkthyesit ndërkulturor janë të specializuar për të pasur konsideratë për të veçantat kulturore gjatë përkthimit. Për kuptimin dhe shkrimin e letrave dhe për plotësimin e formularëve mund të merret për ndihmë një person i besueshëm (ndërmjetësimi bëhet nga zyra e specializuar për shoqërinë).

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-glarus.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/gjuha

Mësimi i gjermanishtes

Për të mësuar saktë gjermanisht ju sygjerohet ta vijoni një kurs të gjuhës gjermane. Oferta për kurse në Kantonin Glarus është e gjerë dhe e përshtatur për situata të ndryshme jetësore.

Ofertat

Në Kantonin Glarus shumë ofertues ofrojnë kurse të gjuhës për grupe të ndryshme. Disa ofertues janë ndërmarrje komerciale, të tjerët janë me interes publik ose instuticione shtetërore. Kush ende nuk e zotëron alfabetin latin apo ka vështërsi me shkrim dhe lexim mundet ta vijoj një kurs për alfabetizim (Alphabetisierungskurs). Para se ta vijoni kursin e gjuhës gjermane duhet të informoheni për llojet e kurseve të ndryshme dhe sa kushtojnë ato. Për nënat me fëmijët të vegjël, pranë shumë Komunave, ka kurse speciale me përkujdesje për fëmijët (MuKi-Deutsch). Zyra e specializuar për shoqërinë (Fachstelle Gesellschaft) ju informon për ofertat.

Nivelet gjuhësore

Si matës i njohurive gjuhësore në gjermanisht shërben shpesh "Korniza e përbashkët evropiane" (GER). Të gjashtë nivelet gjuhësore të vendosura sipas radhës njëra mbi tjetrën fillojnë nga A1 (fillimi) dhe përfundojnë te C2 (njohuri të shkëlqyeshme). Shumica e kurseve të gjuhës gjermane janë të orientuara në këto nivele. Nivelet A1 dhe A2 ju përgjigjen njohurive bazike të gjuhës gjermane. Kush pretendon të vijoj arsimim profesional, në shumicën e rasteve, duhet ta zotëroj nivelin B1 ose B2. Nivelet C1 dhe C2, për ata që kanë përparuar shumë, janë parakusht për studime pranë univerziteteve.

Nivelet gjuhësore në ligjin për të huaj dhe të drejtat qytetare

Për të paraçitur kërkesën për lejen e qëndrimit (B), lejën e përhershme të qëndrimit (C) ose për të marrë shtetësinë, për personat të cilët flasin gjuhë të huaja, nevojitet dëshmia e aftësisë gjuhësore. Sekcioni i migrimit dhe shërbimi i të drejtave qytetare (Abteilung Migration und Bürgerrechtsdienst) ju njoftojnë në lidhje me parakushtet e nevojshme.

Financimi

Sipas rregullit kurset e gjermanishtes duhet të paguhen vet. Çmimet janë të ndryshme dhe ia vlenë që ofertat (çmimi për një njësi mësimore) të krahasohen me njëra tjetrën. Disa kurse mbështeten financiarisht prej Kantonit Glarus dhe për këtë arsye janë më të volitshme.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-glarus.ch/sq/gjuha-dhe-integrimi/me-mesue-gjermanisht